



**BASHKIA TIRANËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 50, datë 11.11.2015

Për

**“DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK NR.49, DATË
19.12.2008 “PËR DISA NDRYSHIME NË NIVELIN E PAGAVE TË
PUNONJËSVE TË BASHKISË SË TIRANËS” (I NDRYSHUAR)”**

Në mbështetje të nenit 32, gërma “ç” të ligjit nr.8652 datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar); ligjit nr.152/2013 “ Për nëpunësin civil” (i ndryshuar); ligjit 9936, datë 26.06.2008 për “Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; nenit 5, gërmat “a” dhe “d” të ligjit nr.10405, datë 24.3.2011 për “Kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”; vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të qeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore” (i ndryshuar); vendimit të Këshillit Bashkiak nr.49, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës” (i ndryshuar) dhe vendimit të Këshillit Bashkiak të Tiranës nr.28, datë 23.12.2014, “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2015-2017 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë së Tiranës për vitin 2015” (i ndryshuar), me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

V E N D O S I:

1. Niveli i pagave i përcaktuar në pikat 1, 2, dhe 3 të vendimit të Këshillit Bashkiak nr.49, datë 19.12.2008 për “Disa ndryshime në nivelin e pagave në Bashkinë e Tiranës” (i ndryshuar), të ndryshohet sipas lidhjeve nr.1, 2 dhe 3 bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efektet financiare të këtij vendimi fillojnë nga 1 Tetori i vitit 2015 dhe përballohen nga buxheti i Bashkisë së Tiranës për vitin 2015.
3. Për zbatimin e këtij vendimi, ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, Drejtoria e Planifikimit Strategjik dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

K R Y E T A R

ALDRIN DALIPI

Lidhja nr. 1 – Niveli i pagës për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës

E M È R T I M I	Kategoria	Grupi	Paga e grupit	Vjetërsia	Shtesa për pozicion
Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	170 000
Zv/Kryetar i Bashkise	—	—	—	—	134 000
Administrator i Përgjithshëm	I	B	1	2%	118 000
Drejtor i Kabinetit	II	A	1	2%	107 800
Sekretar i Këshillit Bashkiak	II	A	1	2%	107 800
Drejtor i Përgjithshëm	II	A	1	2%	107 800
Këshilltar në Kabinet	II	B	1	2%	91 700
Drejtor Drejtorie	II	B	1	2%	91 700
Përgjegjës Sektori	III	A	1	2%	74 400
Përgjegjës Sektori	III	a/1	1	2%	65 200
Përgjegjës Zyre	III	B	1ose 2	2%	57 000
Specialist I	III	B	1ose 2	2%	57 000
Specialist II	IV	A	1ose 2ose 3	2%	45 800
Specialist III	IV	B	1ose 2ose 3	2%	35 500
Sekretar i kryetarit	IV	A	1ose 2ose 3	2%	45 800
Specialist me arsim te mesëm	—	—	—	—	34 000
Sekretare	—	—	—	—	34 000

Lidhja nr. 2 – Niveli i pagës për punonjësit me kontratë.

Nr	Emërtimi	Paga
1	Punonjës shërbimi	34 000

Lidhja nr. 3 – Niveli i pagës për punonjësit e Policisë Bashkiake

Nr	Emërtimi	Paga
1	Kryeinspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	86 850
2	Inspektor i Policisë Bashkiake të Tiranës	69 150
3	Punonjës i Policisë Bashkiake të Tiranës	52 500
4	Inspektor i Policisë Bashkiake ne Njesite Administrative nga 5 001-50 000 banorë	42 000
5	Punonjës i Policisë Bashkiake ne Njesite Administrative nga 5 001-50 000 banorë	40 000
6	Punonjës i Policisë Bashkiake ne Njesite Administrative deri në 5 000 banorë	34 800